



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 2275 / prot. 2

Gramsh, më 09.07 /2023

VENDIM

Nr. 49, datë 30.06.2023

PËR

**Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasit Syrja Murati, banor lagjia "Sporti I", bashkia Gramsh, si dhe dëmshpërblim in financiar të kësaj familje.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2023, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile ,bazuar në: Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndyshuar; Ligjin 45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore";

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për dëmet ndërtimore si dhe ato në pajisje e orendi të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 të përlllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë, për shtetasin Syrja Murati në vlerën 1 681 580 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit Syrja Murati, ndihmën emergjente në vlerën prej 1 681 580 ( një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë ) lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2023.
4. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Syrja Murati, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr 329, date 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Syrja Murati, banesa e të cilëve është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike ( Sektori Emergjencave Civile ), si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financar
7. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Enis ZANI

Konceptoi: Sh.Gjini  
Pranoi: E.Zani  
Miratoi: E.Zani  
Dosja nr: